



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 22 datë 30.03.2026

PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS, PROJEKTI I DETAJUAR I QENDRËS
MULTIFUNKSIONALE, MASTERPLANI I PIKAVE TË INTERESIT, PARKIMI
DHE RRETHIMI I SIGURISË I PARKUT, QYTETET ANTIKE TË BYLISIT DHE
KLOSIT”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË MALLAKASTËR

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “AICS Tirana” Dega Shqipëri, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Parku Arkeologjik Bylis, projekti i detajuar i Qendrës Mul-tifunksionale, masterplani i pikave të interesit, parkimi dhe rrethimi i sigurisë i parkut, qytetet antike të Bylisit dhe Klosit”, me vendndodhje në Bashkinë Mallakastër, me subjekt zhvillues shoqërinë “AICS Tirana” Dega Shqipëri.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Mallakastër.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAIDA ROKA



Nënshkruar më datë 10/07/2026